

V E N D I M
Nr.690, datë 7.10.1996

**PËR KRIJIMIN, EVIDENCIMIN DHE ADMINISTRIMIN E TË ARDHURAVE QË
REALIZOJNË QENDRAT E FORMIMIT PROFESIONAL NGA SHËRBIMET QË ATO U
OFROJNË TË TRETËVE**

Me propozimin e Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Qendrat e formimit profesional, të cilat financohen kryesisht nga buxheti i shtetit, kanë të drejtë që, krahas veprimtarisë së tyre kryesore, të kryejnë edhe veprimtari të tjera kundrejt pagesës, që specifikohen në udhëzimet përkatëse të Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale për zbatimin e këtij vendimi.
2. Fitimi që krijojnë këto qendra nga shërbimet ose veprimtaritë që ato u ofrojnë të tretëve, të derdhet në një llogari të veçantë dhe jo në llogarinë ku financohen shpenzimet e buxhetit të shtetit.
Në fund të çdo tremujori ministria dhe qendrat e formimit profesional rakordojnë me drejtorinë e buxhetit në Ministrinë e Financave për masën e realizimit të tij, 70% e të cilit do të mbahet nga vetë qendrat, kurse 30% do të derdhet në llogarinë e të ardhurave të buxhetit të shtetit.
3. Të ardhurat mund të përdoren për investime, përmirësimin e kushteve të punës, përsosjen teknike ose për nevoja të tjera të qendrave, si dhe për shpërblimin e punonjësve. Kriteri dhe masa e përdorimit të tyre do të përcaktohen më hollësisht në udhëzimin përkatës të ministrisë për zbatimin e këtij vendimi.
4. Të ardhurat që do t'u mbeten qendrave dhe shpenzimet që do të përballohen nga këto të ardhura, të pasqyrohen si aneks në situacionin e shpenzimeve të buxhetit të shtetit.
5. Këtij vendimi t'i nënshtrohen të ardhurat e realizuara nga qendra që nga data 1 tetor 1996.
6. Ngarkohet Ministria e Financave që, në bashkëpunim me Ministrinë e Punës dhe Çështjeve Sociale, të nxjerrë udhëzimin përkatës për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi